



IG Metall: **Një komunitet i fuqishëm.**

Mbi 2 milionë punonjës janë bashkuar në IG Metall. Së bashku ngremë zërin për kushte të mira pune, paga të drejta, perspektiva pune, vende të sigurta pune, bashkëvendosje dhe demokraci në punë. Puna është pjesë kyçe e jetës sonë.

Përkryerjen e një punë të mirë, mbështetemi tek aftësitë dhe përvoja e përfaqësuesve tanë sindakalë dhe këshilleve të punës. IG Metall i pyet dhe i dëgjon njerëzit. Çështjet e nxehta për shumë njerëz përcillen në diskutimet politike. Kështu, IG Metall me këshillet e saj të punës, përfaqësuesit sindakalë dhe anëtarët aktivë, ka arritur vazhdimisht të sigurojë të ardhura më të larta, kohë më të shkurtra pune dhe leje më të gjata.

Ne vendosim standarde edhe për zhvillimet ndërsektoriale: Punësimi i pasigurt, puna e përkohshme, e drejta e punësimit pas shkollimit ose fleksibiliteti i daljes në pension – ne caktojmë çështjet dhe propozojmë zgjidhjet. Dhe falë anëtarëve tanë të shumtë, kemi fuqinë për t'i mbrojtur këto. Qëllimi ynë është një shoqëri me një rend ekonomik social, demokratik dhe ekologjik që t'u ofrojë të gjithëve një mjedis pune dhe jete të drejtë. Vlerat tona janë drejtësia, dinjiteti dhe respekti dhe udhëhiqemi nga parimet e bashkëvendosjes dhe solidaritetit.

**Njerëz të mirë.
Rezultate të
shkëlqyera.**



Ne. **IG Metall.**

Ne sjellim së bashku 2 milionë punonjës nga sektorët e metalurgjisë dhe industrisë elektrike, hekurit dhe çelikut, tekstileve dhe veshjeve, drurit dhe plastikës, zejtarisë dhe shërbimeve, si dhe të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit. Ka shumë arsye për të qenë anëtar i IG Metall.

Kushte të drejta pune

Rezultati ynë më i rëndësishëm janë kontratat kolektive. Ne negociojmë me punëdhënësit kryesisht për anëtarët tanë. Vetëm ata e kanë të drejtën ligjore të përfitojnë kontrata kolektive. Kontratat kolektive rregullojnë pikat kryesore si sasia e të ardhurave, koha javore e punës, e drejta dhe pagesa e lejes, shpërblimet e ndryshme, e drejta e punësimit për praktikantët, e drejta për vazhdimin e trajnimeve dhe zhvillimit profesional si dhe e shëndetit dhe sigurisë në punë. Kontratat kolektive mundësojnë njëkohësisht edhe të drejta të tilla si formimi me kohë të pjesshme ose e drejta e punonjësve më të vjetër për një kalim fleksibël në pension.

Sa më shumë kontrata kolektive gjithëpërfshirëse të lidhim mundësisht në shumë kompani, aq më shumë standarde vendosim për sektorë të tërë.

➔ igmetall.de/tarif

Më mirë **me** **kontrata kolektive**

	me kontratë kolektive*	sipas ligjit
Koha javore e punës	35 deri 38 orë në javë	48 orë
E drejta e lejes	gjashtë javë	katër javë
Pagesa e lejes dhe shpërblimi për Krishtlindje	✓	—
Shtesat	✓	vetëm për punën gjatë natës
Përfitimet e pensionit	✓	—
Mbrojtja nga heqja nga puna për punonjësit e moshuar	✓	—
E drejta e punësimit për praktikantët	✓	—
Rritja e rrogës pas lidhjes së kontratës kolektive	✓	—
Punonjësit e përkohshëm	Përparësi për anëtarët përmes pagesave shtesë	—

* ndryshon në varësi të zonës së kontratës kolektive dhe sektorit

A do të dish më shumë detaje?

➔ igmetall.de/tarif/tariftabellen



Kompetentë **në fushën e punës.**

Ne jemi të fortë në rajon. IG Metall mbështet mbi 110 000 këshille pune, përfaqësues sindikalë, përfaqësues të rinjve dhe praktikantëve dhe përfaqësi punonjësish të gjymtuar rëndë, në mbi 145 seli. Këtu diskutohen kërkesa, zhvillohen strategji dhe nxiten veprime operative.

Edhe për ty si anëtar, IG Metall është pika kryesore e kontaktit: Ne do t'iu përgjigjemi të gjitha pyetjeve të tua në lidhje me botën e punës – qoftë nëse bëhet fjalë për kontrollimin e kontratave të punës ose referencave, asistencë në rast shkarkimi nga puna ose shqyrtim të vendimeve të pensionit. Në të ofrojmë një mbështetje profesionale, të këshillojmë, të përfaqësojmë në çështjet jashtë gjykatës dhe nëse është nevoja, sigurisht edhe në gjykatë.

Fjalori

Ligjore

Rezultati ynë më i rëndësishëm. Jemi të fortë dhe kompetentë në punën vullnetare. Mbi 4000 anëtarë të IG Metall angazhohen vullnetarisht për të drejtën e punës dhe atë sociale në gjykatë.

Kontratat kolektive

Kontratat tona kolektive vendosin standarde që prej vitit 1956 dhe historia e suksesit të IG Metall vazhdon.

Koha e lirë

Të siguruar, edhe në kohën e lirë. Sigurimi nga aksidentet në kohën e lirë mbulon gjithë aksidentet jashtë profesionit.

Materiale informuese

Përgjigjet për të gjitha pyetjet kryesore rreth IG Metall i gjeni në paketën tonë informuese gjithëpërfshirëse.

Shërbimet tona janë pjesë e statutit të IG Metall dhe të gjithë anëtarët mund të përfitojnë prej tyre në varësi të kohëzgjatjes së anëtarësisë

Program i fuqishëm: **shërbimet tona statutore.**

1. Mbrojtja ligjore.

§27 i statutit të IG Metall

Mosmarrëveshjet me punëdhënësin ose një agjenci sigurimesh shoqërore ndonjëherë nuk mund të shmangen, për shembull, pas një aksidenti në punë, pas një paralajmërimi ose shkarkimi nga puna, për shkak të sëmundjeve afatgjata ose mbi shumën e pensioneve ose pagave. Këto mosmarrëveshje ndodhin më shpesh se ç'mendohet: Rreth 2000 padi bëhen çdo ditë në gjykatat e punës dhe çështjeve sociale. Të tilla procese janë të kushtueshme.

Ekspertët ligjorë të IG Metall dhe DGB Rechtsschutz GmbH përfaqësojnë interesat e tua në përgatitjen e procesit gjyqësor, por edhe në gjykatë, nëse nevojitet. Kjo mbështetje që u jepet anëtarëve të IG Metall është pa pagesë. Mbrojtja ligjore përfshin shumë rezeqe me të cilat përballemi gjatë punës sonë ose kur kemi të bëjmë me autoritetet. Ne rikuperojmë rreth 110 milionë euro çdo vit për anëtarët tanë. Por këtu bëhet fjalë për më shumë se paratë: Paga e rimbursuar, e drejta për shpërblime, e drejta për pensione më të larta – kjo është për ne gjithmonë një pjesëz e drejtësisë shoqërore. Joanëtarët duhet të marrin përsipër gjithë kostot e procesit, nëse e humbasin atë. Ndërsa anëtarët nuk marrin përsipër as kosto e as rezeqe.

Shembull për procesin e mbrojtjes nga shkarkimi nga puna:

Kur vlera e procesit gjyqësor është 12 250 euro, merren për bazë 3,5 rroga mujore prej 3500 eurosh në muaj.

	Joanëtarët	Anëtarët
Shkalla e parë		
Shpenzimet e gjyqit (pa shpenzime e procesit, si p.sh. Kompensimi i rëve)	590,00 €	0,00 €
Shpenzimet e avokatit	2 005,15 €	0,00 €
Totali (me 19 % TVSH të përfshirë)	2 595,15 €	0,00 €
Shkalla e dytë		
Shpenzimet e gjyqit	944,00 €	0,00 €
Shpenzimet e avokatit	2 242,91 €	0,00 €
Shpenzimet e avokatit kundërshtar	2 242,91 €	0,00 €
Totali (me 19 % TVSH të përfshirë)	5 429,82 €	0,00 €
Përveç kësaj, mund të ketë shpenzime udhëtimi të avokatit dhe shpenzime dokumentacioni.		

Mbrojtja ligjore përfshihet në tarifën e anëtarësisë. Pika kryesore e kontaktit është gjithmonë IG Metall lokale.

➔ igmetall.de/vor-ort

➔ igmetall.de/rechtsschutz

Shembull:

Kushdo që është anëtar prej më shumë se pesë vjetësh dhe ka paguar një kontribut mesatar mujor prej 25 eurosh gjatë tre muajve të fundit, përfiton 350 euro mbështetje financiare javore për grevën (70 euro për një ditë grevë gjatë një jave me 5 ditë).

Program i fuqishëm: **shërbimet tona statutores.**

2. Përkrahje në rast greve.

§23 i statutit të IG Metall

Përmes grevave bëjmë që zëri ynë të dëgjohet dhe fitojmë respekt. Me aftësinë tonë për të mbështetur grevat matet edhe fuqia jonë për të vepruar e po ashtu edhe pesha jonë politike. Grevat nuk janë një qëllim në vetvete, por ndonjëherë të pashmangshme, ndaj IG Metall i mbështet sigurisht anëtarët e saj edhe financiarisht. Mbështetja në rastet e grevave përllogaritet për çdo anëtar të prekur, në bazë të kohëzgjatjes dhe shumës së kontributeve personale. Nga kjo përjashtohen zakonisht aksionet paralajmëruese të grevave.

Normat e mbështetjes për një javë grevë janë:

- ▶ nëse janë paguar kontribute për **3 deri 12 muaj**, 12-fishi i kontributit mesatar të tre muajve të fundit*
- ▶ nëse janë paguar kontribute për **12 deri 60 muaj**, 13-fishi i kontributit mesatar të tre muajve të fundit*
- ▶ nëse janë paguar kontribute për **60 muaj**, 14-fishi i kontributit mesatar të tre muajve të fundit*.

*para muajit kalendarik të votimit

Kohëzgjatja e anëtarësimit është e rëndësishme për përllogaritjen e mbështetjes financiare të grevës.

3. Mbështetje në rast sanksionesh dhe masash bllokuese.

§24 i statutit të IG Metall

Një gjë është e qartë: Nëse anëtarët tanë angazhohen në sindikata, nuk do të kenë asnjë disavantazh nga kjo. Nëse punëdhënësi shkakton probleme, për shembull, duke kërcënuar përmes disavantazheve ose duke imponuar sanksione apo duke bërë diskriminime, ne i mbështesim anëtarët tanë gjatë gjithë procesit.

Përveç kësaj, anëtarët tanë nuk mund të kenë disavantazhe nëse marrin pjesë në aksionet greviste të vendosura nga IG Metall. E njëjta gjë vlen edhe për masat bllokuese, nëse aksioni grevist është vendosur nga bordi i IG Metall.

➔ igmetall.de/leistungen



Program i fuqishëm: **shërbimet tona statutores.**

4. Sigurimi kundër aksidenteve në kohën e lirë.

§26 i statutit të IG Metall

Rrëzim gjatë pushimeve me ski apo lëndim gjatë një ekskursioni me biçikletë? Punonjësit janë të siguruar ligjërisht kundër aksidenteve në punë, por IG Metall u siguron anëtarëve të tyre edhe mbështetje kundër aksidenteve në kohën e lirë. Sigurimi ynë kundër aksidenteve në kohën e lirë mbulon aksidente jashtë profesionit dhe shtrihet në gjithë botën. Kjo do të thotë që është e vlefshme si në fushën e sportit, ashtu edhe në atë të kopshtarisë ose çiklizmit në pushime.

➔ igmetall.de/leistungen

Pas muajit të 13-të të anëtarësimit hyn në fuqi automatikisht sigurimi kundër aksidenteve në kohën e lirë, nëse kontributi statutor është paguar pa ndërprerje. Sigurimi përfshin shërbimet e mëposhtme:

Pagesa për spitalin

- ▶ Në rastin e qëndrimit në spital për të paktën tre ditë, anëtarët përfitojnë një kontribut të njëhershëm deri në 30-fishin e mesatares së kontributeve të 12 muajve të fundit, që janë paguar para aksidentit
- ▶ maksimumi 51,13 euro për çdo ditë qëndrim në spital,
- ▶ të paktën 154,00 euro pagesë e njëhershme.

Invaliditeti

- ▶ Në rast invaliditeti të plotë, jepet 500-fishi i kontributit mujor si dëmshpërblim i njëhershëm.
- ▶ Në rast invaliditeti të pjesshëm prej të paktën 20%, jepet shuma përkatëse e pjesshme.

Vdekje nga aksidenti

- ▶ Në rastin e vdekjes nga aksidenti, familjarët do të marrin 200-fishin e kontributit mujor.



Program i fuqishëm: **shërbimet tona statutore.**

5. Mbështetje në raste emergjencash të jashtëzakonshme.

§28 i statutit të IG Metall

Si pjesë e një komuniteti solidar, mund të mbështeteni tek njëri-tjetri kur gjërat vështirësohen.

Anëtarët e IG Metall që ndodhen në një emergjencë të jashtëzakonshme për shkak të një ngjarjeje të paparashikueshme, mund të aplikojnë për mbështetje financiare. Pas përshkrimit të personalizuar të emergjencës, zyra e IG Metall do të vendosë lidhur me kërkesën dhe do të përcaktojë shumën mbështetëse.

Emergjencat e jashtëzakonshme personale kërkojnë një mbështetje financiare të shpejtë dhe të pakomplikuar. Sigurisht, IG Metall ofron mbështetje edhe në rast katastrofash që rrezikojnë jetën, si për shembull, përmbetje dhe katastrofa natyrore.

➔ igmetall.de/leistungen

6. Unterstützung im Todesfall.

§30 i statutit të IG Metall

Në rast vdekjeje, anëtarët ose familjarët e tyre marrin një mbështetje financiare. Përcaktimi i shumës mbështetëse bazohet në kontributin mesatar të 12 muajve të fundit nga marrëdhënia e punës.

Për shembull, me një kontribut mujor mesatar prej 27 eurosh dhe një kohëzgjatje të anëtarësimit prej më shumë se 20 vjetësh, mbështetja e njëhershme për familjarët është 851 euro. Anëtarët marrin gjysmën e shumës së lartpërmendur në rast vdekjeje të partnerit të tyre.

Kështu IG Metall ofron një shërbim të veçantë mbështetës, duke qenë se kompensimi ligjor në rast vdekjeje është hequr nga Kodi gjerman i Sigurimeve Shoqërore, pa zëvendësim.

➔ igmetall.de/leistungen

Mbështetja në raste emergjencash të jashtëzakonshme dhe në rastet e vdekjes, duke filluar nga muaji i 13-të i anëtarësimit, nëse kontributi statutor është paguar pa ndërprerje.



Ofertat tona.

Seminaret

IG Metall ofron në nivel lokal, rajonal dhe qendror një gamë të gjerë seminaresh për kualifikimin sindikal, profesional dhe personal. Nëse nuk duhet të financohet nga punëdhënësi, pjesëmarrja është falas për anëtarët.

➔ igmetall.de/weiterbildung

metall. Dein Magazin

Revista e anëtarëve tanë “metall. Dein Magazin” sjell çdo dy muaj lajme aktuale e interesante rreth sektorëve dhe kompanive, si dhe informacione të dobishme rreth jetës së punës, të drejtës së punës, politikës dhe shoqërisë.

➔ igmetall.de/metallzeitung

Aplikacioni IG Metall

Anëtarët tanë mund të gjejnë lehtësisht online informacione ekskluzive rreth temave dhe çështjeve që lidhen me botën e punës, temat sociale e politike, ciklet e marrëveshjeve kolektive, këshilltarët e shumë të tjera. Këtu mund ta gjesh aplikacionin: App-Store (për iOS), PlayStore (për Android).

➔ igmetall.de/app

Vetëshërbimi në IG Metall

Këtu mund të ruash të dhënat e tua, të shkarkosh mandat-pagesat e kontributeve e shumë të tjera.

➔ igmetall.de/service/mein-servicecenter


Aktivë në vend.

mund të marrë pjesë aktive në punën tonë sindikale. Ka grupe projekti, grupe pune dhe evente për tematika të ndryshme. Më shumë informacione lidhur me këtë janë të disponueshme pranë selive ose në faqet përkatëse të internetit. Selinë tënde lokale të IG Metall e gjen në:

➔ igmetall.de/vor-ort

Të fortë në rajon.

Nga Flensburg deri në Lörrach,
nga Aachen deri në Bautzen.





Shërbime shitesë për anëtarët e sindikatës.

IGM-Service GmbH ofron për anëtarët tanë dhe familjarët e tyre shërbime të larmishme që lidhen me kushtet e tyre të jetesës dhe të punës, si për shembull:

Regjimet e pensionit

Sigurimet për kushtet e drejta, për shembull, pensionet e Metall (regjimet e pensioneve të kompanisë), Metall Plus (sigurimet private për kushte të veçanta), GUV/Fakulta (përgjegjësia në punë), mbrojtja nga humbjet e fitimeve (pa kontroll shëndetësor), si dhe kushtet e reduktuara në palestrën Fitnessloft.

Formimi

Shërbime formimi profesional dhe sindikal, bileta me çmim të ulët për seminare dhe evente, Academy of Labour (trajtime dhe specializime në nivel akademik në fushat e bashkëvendosjes dhe marrëdhënieve të punës si dhe në plan personal dhe në menaxhim) dhe shkolla në distancë sgd (studime në distancë ose një kualifikim i mëtejshëm gjatë punës).

Këshillim për tatimin mbi të ardhurat

Mbi 3000 qendra këshillimi të shoqatave për asistencë fiskale janë në dispozicion të anëtarëve të IG Metall. Anëtarët nuk e paguajnë tarifën e pranimi dhe sipas të ardhurave, ka edhe një kontribut të përshkallëzuar social.

Koha e lirë

Evente dhe manifestime kulturore me zbritje çmimi në nivel kombëtar, si dhe në afërsi, si për shembull në Center Parks, Holiday Park, Legoland etj.

Udhëtimet: Shërbime me çmime speciale për HRS, GEW dhe qiramarrjen e automjeteve.

Rajonale: Shërbime interesante si për shembull, shërbime këshillimi ose formimi dhe përparësi në blerjet pranë furnizuesve dhe dyqaneve lokale.

Dyqane: Çmime speciale nga librat deri në artikujt për fansat.

 [igmservice.de](https://www.igmservice.de)



Një investim në një punë të mirë.

Të gjitha shërbimet tona financohen nga kontributet e anëtarëve tanë. Në këtë mënyrë, çdo anëtar kujdeset me anë të kontributeve statutorë, jo vetëm për veten e tij por edhe për të tjerët. Ky është parimi i solidaritetit. Kontributet individuale nga mbi 2 milionë njerëz na bëjnë të fortë dhe mbi të gjitha më të aftë për të vepruar.

Statuti parashikon shumat e mëposhtme të kontributeve: Punonjësit paguajnë një përqindje nga të ardhurat mesatare mujore bruto. Të papunët, personat në pension dhe studentët paguajnë një kontribut të reduktuar.

Çdo ndryshim në kushtet e jetesës apo marrëdhëniet e punës që sjell ndryshim në kontribute, duhet t'i komunikohet menjëherë zyrës kompetente lokale. Kjo është e rëndësishme edhe për arsye se shërbimet mbështetëse bazohen në kontributet e derdhura faktike.

Kontributi i anëtarësimit – kush paguan dhe sa?

Normat mujore të kontributeve në IG Metall

1%

të të ardhurave
mesatare bruto

- ▶ Personat e punësuar me kohë të plotë, të pjesshme ose me pension të pjesshëm, në praktikë profesionale/studim të dyfishtë etj.
- ▶ Punonjës të pavarur individualë

0,5%

i kompensimit të
pagesës mujore bruto

- ▶ Të papunët me ndihma për papunësinë
- ▶ Pensionistët
- ▶ Të sëmurët me pagesë kompensuese
- ▶ Ndjekës trajnimesh profesionale me të ardhura nga sigurimet shoqërore

3€

- ▶ Të papunët me ndihmë për qytetarët
- ▶ Studentët/nxënësit në trajnim me kohë të plotë
- ▶ Persona me leje lindje (zakonisht)
- ▶ Të sëmurët me ndihma sociale
- ▶ Personat me falimentim privat, lirim të papaguar nga puna, kujdes me kohë të plotë nga të afërmit etj.

0€

pa kontribut
zakonisht 6/12 muaj

- ▶ Vullnetarët e shërbimit ushtarak
- ▶ Vullnetarët e shërbimit civil/social

➔ igmetall.de/mitmachen/mitglied-werden/wer-zahlt-wie-viel-mitgliedsbeitrag



Anëtarët tanë janë në qendër të punës sonë.

Përkë të arsye, pjesëmëemadheehyrjeve ngakontributet përdoret për punë lokale. Kështu, paratë janë në dispozicion atje ku kompanitë ndiqen në mënyrë aktive dhe anëtarët tanë marrin këshillim dhe mbështetje.



Në IG Metall **në shoqëri të mirë.**

Të rinjtë: të jesh aktiv – të krijosh perspektiva

IG Metall Jugend përfaqëson aktivisht dhe me besim interesat e praktikantëve, studentëve dhe të rinjve që janë në fillim të karrierës së tyre. Anëtarët e IG Metall të moshës 16 deri 27 vjeç punojnë fort së bashku këtu për vetëvendosje, bashkëvendosje dhe perspektiva profesionale.

➔ igmetall.de/jugend

Të punësuarit: shumë profesione – një qëllim i përbashkët

Punonjësit e zyrës, inxhinierët dhe informatikanët janë të angazhuar në IG Metall po aq sa edhe teknikët dhe akademikët. Një punë e mirë në zyrë vjen nga punonjës të organizuar mirë, të cilët mundësojnë kontrata kolektive për rroga më të larta, kushte të mira pune dhe vende pune të sigurta me perspektiva profesionale. Teknologjitë e reja (për shembull, inteligjenca artificiale) dhe format e reja të punës (si puna fleksibël dhe e lëvizshme, tavolinat e përbashkëta etj.) rregullohen më mirë së bashku me punonjësit. Së bashku mund të formësojmë transformimin digjital!

Inxhinierët: shumë të kualifikuar dhe me një rrjet të mirë

janë të organizuar si në sektorët tipikë metalurgjikë dhe elektrikë, si dhe të teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit (TIK) dhe në ofruesit e shërbimeve zhvilluese. Në rrjetet tona, shkëmbejmë idetë dhe

përvojat tona, edhe për të gjetur zgjidhje të mira në kontratat kolektive për botën tonë të punës. Me krahasimin e pagave përmes TIK-ut kujdesemi që të ketë nivele të krahasueshme, transparencë dhe të vendoset standardi për shumë punonjës që nuk kanë kontrata kolektive.

➔ itk-entgeltanalyse.igmetall.de

Punonjësit me punë të përkohshme

»**Punë e mirë përtë gjithë**« – me këtë kërkesë po i bëjmë presion të palodhur sferës politike dhe ekonomike. Kontratat tona kolektive u japin punonjësve të përkohshëm më shumë para, më shumë të drejta dhe më shumë mundësi për t'u punësuar.

Shpërblim për anëtarët: punonjësit e përkohshëm që janë anëtarë të IG Metall prej të paktën 6 muajsh, marrin një pagesë shtesë për pushime dhe Krishtlindje, nëse janë të punësuar për më shumë se gjashtë muaj në kompaninë e punësimit të përkohshëm.

Punonjës të pavarur individualë: por jo vetëm

IG Metall ofron shërbime që përputhen me nevojat e punonjësve të pavarur individualë, në mënyrë që të mos jenë vetëm në rast emergjencash. Ne angazhohemi për të përmirësuar kushtet e punës dhe mbrojtjen sociale të punonjësve të pavarur.

Në IG Metall në shoqëri të mirë.

Gratë, prindërit dhe familja: së bashku për mundësi të barabarta

Ne angazhohemi për të garantuar mundësi të barabarta zhvillimi profesional, për pagesa të drejta dhe ekuilibër midis profesionit dhe jetës. Kjo u sjell përparësi grave. IG Metall fiton pikë me qindra mijëra kolegë, falë angazhimit të saj për më shumë barazi dhe orare pune të vetëvendosura. Me kontratat kolektive krijojmë më shumë drejtësi.

➔ igmetall.de/vereinbarkeit

Studim, praktikë dhe punë gjatë pushimeve: të fortë së bashku – që nga fillimi

Edhe para se të hyni në punë, ia vlen të jeni anëtar i IG Metall. Ne kontrollojmë kontratat e praktikantëve dhe ato të punës, ofrojmë këshillim për tema si financimi i studimeve, punët me kohë të pjesshme dhe rrogat fillestare, si dhe ofrojmë seminare falas për fillimin e karrierës dhe menaxhimin e kohës, për njohjen e të drejtave vetjake dhe hyrjen në botën e punës.

➔ igmetall.de/studierende

Pensionistët: të fortë së bashku – për gjithë jetën

Ne i shoqërojmë anëtarët tanë gjatë kalimit në pension, duke u ofruar informacione të dobishme dhe shërbimet e zakonshme. Edhe mbrojtja e të drejtës sociale pa pagesë vazhdon edhe pas jetës aktive të punës. Në rast problemesh me sigurimin e pensionit, sigurimin shëndetësor ose kompanitë e sigurimeve shoqërore, qëndrojmë gjithmonë pranë anëtarëve tanë. Sepse është vendi i tyre, edhe pas jetës së tyre të punës.

Të papunët: të priten në vend të zhvlerësohen

Papunësia mund të prekë këdo. Ne i mbështesim anëtarët tanë dhe u japim këshilla praktike, si për shembull, si të veprojnë me agjencinë e punësimit, si dhe u ofrojmë ndihmë për të kërkuar asistencën e papunësisë II dhe i mbështesim në çështjet e ligjit të punës.

Migrimi/Integrimi: Promovojmë diversitetin – Luftojmë diskriminimin

IG Metall ka diversitet! Është shtëpia politike dhe sindikale për shumë njerëz me sfond emigracioni. Me mbi 500 000 anëtarë me sfond emigracioni, ajo është organizata më e madhe për këtë. Së bashku angazhohemi për barazinë dhe kundër diskriminimit.

➔ igmetall.de/migration

Vullnetarët në IG Metall: Personat e angazhuar kontribuojnë

Ata krijojnë bazat në edukim dhe formim profesional, flasin për drejtësi ose luftojnë për kushte më të mira pune: mijëra anëtarë të IG Metall ofrojnë kohën e tyre vullnetarisht në komitete, dhoma tregtie ose shoqata tregtare. Suksesin e angazhimeve të tyre e ndiejnë punonjësit në shumë vende pune.



Ajo që kemi arritur deri tani: **Arritjet tona historike.**

Historia e IG Metall i ka fillesat e saj në vitin 1891 me themelimin e Shoqatës së Punëtorëve të Metalurgjisë. Ajo ishte organizata më e madhe pararendëse e asaj që sot quhet IG Metall.

Pas Luftës së Dytë Botërore, në Gjermaninë Perëndimore u rithemeluan sindikatat, sipas parimit të sindikatave të unifikuara. Ne, IG Metall, kemi luftuar së bashku për qëllimet tona që në vitin 1949. Që atëherë, kemi arritur shumë përmes politikës sonë të kontratave kolektive. Ndër sukseset e IG Metall mund të përmendim:

- ▶ Rritjen e pagave, pra pjesëmarrja financiare të punonjësve në suksesin ekonomik të kompanive dhe bizneseve
- ▶ Shkurtimi i orëve javore të punës
- ▶ Më shumë të drejta për pushimin e paguar vjetor
- ▶ Pagesa shtesë për pushime dhe Krishtlindje
- ▶ Mosndërprerje e pagës në rast sëmundjesh
- ▶ Sigurim i të ardhurave dhe mbrojtje nga shkarkimi nga puna për punonjësit e vjetër

- ▶ E drejta e punësimit të praktikantëve
- ▶ Shtesa në varësi të sektorit dhe përshtatje e pagesave për punonjësit e përkohshëm
- ▶ Rregullore për bashkëvendosjen
- ▶ më shumë vetëvendosje për kohën e punës
- ▶ Vendosja e pagesës vjetore për transformimin, ose blloku i transformimit
- ▶ dhe strukturë kolektive për kontratat e ardhshme.



Sukseset e kontratave kolektive në rrafsh kronologjik

Vitet '50 Kohë më e shkurtër pune dhe sigurim në rast sëmundjesh edhe për punonjësit

Pak vite pas themelimit të saj, IG Metall arriti të sigurojë shkurtimin e kohës së punës gradualisht nga 48 në 44 orë, me kompensim të plotë të pagës. Në vitin 1957, me grevën më të gjatë në historinë e Republikës Federale, kemi luftuar për mosndërprerjen e pagesës në rastet e sëmundjes, duke hedhur kështu themelet për trajtim të barabartë të punëtorëve dhe punonjësve. Pak muaj më vonë parlamenti federal miraton “Ligjin për përmirësimin e sigurisë ekonomike të punëtorëve në raste sëmundjesh”, pararendës i ligjit të sotëm për mosndërprerjen e pagave. Edhe sot është i vlefshëm për gjithë punonjësit.

Gjithashtu: paga deri në 6% më shumë!

Vitet '60 Koha e revolucionit: rritje të theksuara pagash dhe më shumë pushime

IG Metall lufton për rritje pagash deri në 8,5% thujse çdo vit, pasi ekonomia është në lulëzim dhe pagat nuk mund të mbeteshin pas. Njëkohësisht, në luftën për ditën 8-orarëshe të punës, arritëm vendosjen graduale të 40 orëve të punës në javë me kompensim të pagës. U ra gjithashtu dakord për zgjatjen e pushimeve nga tre deri në gjashtë ditë, dhe për herë të parë u shtua në kontratat kolektive një pagesë shtesë për pushimet prej 30%.

Gjithashtu: paga deri në 8,5% më shumë!

Vitet '70 Sigurimi i punës dhe paga e 13-të

Vitet '70 që ishin aktive në rrafshin shoqëror, karakterizohen sërish nga greva të rëndësishme, ndër të tjera në industrinë e çelikut. IG Metall u siguron anëtarëve të saj një pjesë të pagës së 13-të. Paga mujore. Për herë të parë lidhëm gjithashtu një kontratë kolektive për kontributet për formim kapitali. Këtu përfshihet një plan me faza për pushimet 30-ditore që janë të vlefshme ende sot, dhe për rritjen e pagesës së pushimeve në 50%. Gjysma e dytë e viteve '70 është karakterizuar në rrafshin shoqëror dhe politik nga shkarkimet nga puna në masë dhe krizat e para ekonomike. Përgjigjet e IG Metall janë marrëveshja për mbrojtjen kundër racionalizimit, mbrojtjen kundër deklasimit dhe sigurimin e pagave, si dhe mbrojtjen kundër shkarkimit nga puna për punonjësit më të vjetër.

Gjithashtu: paga deri në 15,3% më shumë!



Sukseset e kontratave kolektive në rrafsh kronologjik

Vitet '80

Në rrugën e duhur drejt javës 35-orëshe

Logoja me diell e javës 35-orarëshe, e krijuar nga IG Metall, lidhet në mënyrë të pandashme me vitet '80. Në vitin 1984, anëtarët tanë hynë në grevë për javën 35-orarëshe. “Asnjë minutë nën 40 orë” ishte kundërpërgjigjja e punëdhënësve, të cilët përjashtuan mbi gjysmë milionë punonjës në kulmin e grevës. E megjithatë, solidariteti mes grevistëve dhe të punonjësve të përjashtuar “të nxehtë” dhe “të ftohtë” nuk mund të thyhej. Pas shtatë javësh grevë, punëdhënësit lëshuan pak pe gjatë ndërmjetësimit. Dogma e tyre thyhet dhe dakordësohet plani me faza përjavën 35-orarëshe me kompensim të plotë të pagës. Përveç kësaj, përfundon plani me faza për zgjatjen e pushimeve, tashmë 30 ditë. Përveç kësaj, arrihet një kontratë kolektive për daljen e parakohshme në pension dhe një kontratë për kontributet për formim kapitali.

Gjithashtu: paga deri në 6,8% më shumë!

Vitet '90

Strukturat e kontratave kolektive për shtetet e reja federale

IG Metall përballon sfidat e ribashkimit dhe krijon struktura sindikale dhe kontratash kolektive në shtetet e reja federale. Zbatimi i planit me faza të harmonizimit të pagave me ato të Gjermanisë Perëndimore duket diçka e vështirë. Pas ndërprerjes së paligjshme të kontratës kolektive me faza nga ana e punëdhënësve, IG Metall hyn sërish në grevë. Kontrata kolektive me faza hyn sërish në fuqi në formë “të zgjatur”. Përveç kësaj, u dakordësua një klauzolë për rastet e vështirësisë për kompanitë e rrezikuara. Në landet e tjetra federale arritëm zbatimin e plotë të javës 35-orëshe. Realizuar një mbrojtje më të mirë të pagës së 13-të, një kontratë kolektive për sigurimin e punësimit dhe provizione më të mira për punësimin e praktikantëve. Përveç kësaj, mbrojtëm mosndërprerjen e 100% të pagës në rast sëmundjesh, që arritëm me mund, kundër gjithë përpjekjeve për ta përkeqësuar atë me ligj.

Gjithashtu: paga deri në 6,7% më shumë!





Sukseset e kontratave kolektive në rrafsh kronologjik

Vitet 2000

Marrëveshja kuadër e pagave, pensioni i pjesshëm dhe sigurinë e vendit të punës

Vitet 2000 janë karakterizuar nga mbrojtja e standardeve tona të kontratave kolektive dhe autonomia e tyre. Me kontratën kolektive kornizë të pagave (ERA) rregulluam sërish klasifikimin e punonjësve në mënyrë më të drejtë. Punët e barasvlershme do të paguheshin njësoj në të ardhmen. Edhe për punonjësit më të vjetër po arrijmë shumë rezultate: Që nga viti 2002, kontrata kolektive vlen si urë punësimi ose për pensionin e pjesshëm dhe nga viti 2008 për kalimin fleksibël në pension. Për më tepër, praktikantët punësohen për 12 muaj dhe përforcohen të drejtat e këshilleve të punës për ankesat dhe bashkëvendosjen. Ato që njihen si “Marrëveshja e Pforzheim” janë klauzolat hapëse të rregulluara të kontratave kolektive për garantimin e konkurrencës dhe sigurisë së vendit të punës. Për të ndaluar përfundimisht keqpërdorimin e punës së përkohshme, IG Metall nis fushatën “Punë e barabartë – para të barabarta”. Kontrata kolektive për pagesë të njëjtë në industrinë e çelikut në vitin 2010 hap rrugën për marrëveshjet e tjera sektoriale në vitet e ardhshme.

Përveç kësaj: paga deri në 3% më shumë në industrinë e drurit dhe të tekstileve, deri në 4,2% më shumë në industrinë metalurgjike dhe atë elektrike!

Vitet 2010

Kundër punësimit të pasigurt:
para të barabarta për punë të barabartë

Në vitin 2012 IG Metall zbaton kontratën e parë kolektive me Shoqatën Federale të Ofruesve të Shërbimeve për personelin dhe me Shoqatën gjermane të Agjencive të Punësimit të Përkohshëm. Për herë të parë punonjësit e përkohshëm në industrinë metalurgjike dhe elektrike do të marrin shpërblime sipas sektorëve dhe një kontratë pune pas 24 muajsh punë në të njëjtën kompani. Më pas, mund të zbatohen rregulloret përkatëse për industrinë e përpunimit të drurit dhe të plastikës, si dhe për industrinë tekstile dhe atë të veshjeve. Përveç kësaj, këshilli i kompanisë do të ketë më shumë zë në kapitull lidhur me punën e përkohshme. Në fillim të vitit 2015 hyn në fuqi paga minimale me ligj, për të cilën sindikatat kanë luftuar për vite të tëra. Kjo mbron pagat e parregulluara me një kontratë kolektive nga një ulje e mundshme, megjithatë, kontratat kolektive të IG Metall për anëtarët e saj janë më të larta se paga e re minimale. Një sukses i madh për të rinjtë e punësuar dhe të drejtën e punësimit pa afat pas formimit në industrinë metalurgjike, elektrike dhe atë të çelikut.

Gjithashtu: paga deri në 4,3% më shumë në industrinë metalurgjike dhe elektrike, deri në 3,6% më shumë në industrinë tekstile dhe atë të veshjeve!



Sukseset e kontratave kolektive në rrafsh kronologjik

Vitet 2020

Të aftë për të vepruar edhe gjatë pandemisë

IG Metall reagon me shpejtësi ndaj pandemisë së koronavirusit dhe ofron një paketë krize për të garantuar punësimin dhe të ardhurat, si dhe për t'u mundësuar prindërve të kujdesen për fëmijët ndërkohë që kopshtet dhe shkollat janë mbyllur. Finalizohen gjithashtu edhe rregulloret për punën me kohë të kufizuar.

Një vit më pas do të përmirësojmë edhe më tej mbrojtjen e punësimit dhe do të finalizojmë një kontratë kolektive për një pagesë vjetore transformimi ose një bllok vjetor transformimi. Gjithashtu do të dakordësohet një kuadër kolektiv për kontratat e ardhshme kolektive dhe përfshirja e studentëve të dyfishtë në kontratat kolektive.

E tashmja

Më shumë vetëvendosje gjatë orarit të punës

Bota e punës po përballet me sfida të mëdha. Njerëzit kanë nevojë për orare pune të përshtatshëm për jetën e tyre. Për këtë ka luftuar IG Metall në industrinë metalurgjike dhe elektrike në vitin 2018: Mbi 1,5 milionë persona dolën së bashku në rrugë. Me sukses – u arrit kalimi në një sovranitet më të madh kohor.

Ndihmë për formësimin e ndryshimeve në botën e punës

Digjitalizimi, ndryshimi i klimës, ndryshimet në lëvizshmëri dhe energji, globalizimi, mjediset e jetesës që po largohen gjithnjë e më shumë: Bota po ndryshon shumë shpejt. Por si do të jetë puna në industri në vitin 2030? Si do të ndikojë digjitalizimi ose ndryshimet në energji dhe lëvizshmëri? Dhe si do ta menaxhojmë këtë transformim ne si metalurgë?

Jemi duke shtruar rrugën me marrëveshje konkrete për të ardhmen, me politikën tonë të kompanive dhe kontratave kolektive, si organizatë. Dhe po sfidojmë punëdhënësit dhe politikën. Në mënyrë që ndryshimet strukturore të mos e prishin strukturën. Në mënyrë që zhvillimi teknologjik të bëhet edhe një zhvillim shoqëror. Për një transformim social, ekologjik dhe demokratik.



Ne. IG Metall.

Një sindikatë që prezantohet.

A do doje të dije më shumë rreth IG Metall?
Revista jonë »Wir. Die IG Metall.« përcjell qartë
atë që përfaqësojmë, atë që ofrojmë dhe se
çfarë nënkupton sindikata. Përfshihet në çdo paketë
informuese dhe mund të porositet falas në

➔ igmetall.de/infopak

Të rrjetëzuar dhe të informuar.
Porosite broshurën tonë informuese në

➔ igmetall.de/info

Impressum

IG Metall
Wilhelm-Leuschner-Straße 79
60329 Frankfurt am Main

Verteten durch den Vorstand,
1. Vorsitzende Christiane Benner
Kontakt: vorstand@igmetall.de

V.i.S.d.P. / Verantwortlich nach § 18 Abs. 2 MStV:
2. Vorsitzender Jürgen Kerner

www.igmetall.de

Stand: März 2025

PN: 1000566A

IG Metall mundëson lidhje.

Ne jemi shumë. Eja edhe ti.



Po. Jam pjesë edhe unë.

Bëhu anëtar direkt online:

➔ igmetall.de/beitreten

Bilder: Titel PeopleImages@istock, S. 2 gettyimages.de/sturti, S. 3 gettyimages.de/gettyimages.de/Ricardolmagen, S. 4, 10 Christian von Polentz, S. 8 istockphoto.com/Frazaio Studio Latino, S. 9 Stephen Petrat, S. 11 istockphoto.com/sommart, S. 13 Thomas Range, S. 14 anonym, igmetall.de, W. Knapp / Thema Pressebüro Karlsruhe, S. 15 igmetall.de, Inge Werth, igmetall.de, S. 16 ISG Frankfurt, Werner Bachmeier, igmetall.de, S. 17 igmetall.de, Markus J. Feger, Thomas Range, S. 18 igmetall.de

Albanisch